



Numri: KSC-BC-2020-05
Prokurori i Specializuar k. Salih Mustafës

Vendosi: Gjykatësi i procedurës paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 28 shtator 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Urdhër për parashtrime në lidhje me gjuhën e punës së procesit

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit për të akuzuarin
Julius von Bóné

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në përputhje me nenin 20 të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar dhe rregullën 8(3)(a) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 14 shkurt 2020, Prokurori i Specializuar dorëzoi për konfirmim një aktakuzë rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* së bashku me materialin provues në mbështetje të fakteve mbi të cilët bazohen akuzat dhe një përmbledhje të detajuar që demonstronte lidhjen e secilës provë me çdo akuzë.²

2. Më 12 qershor 2020, gjykatësi i procedurës paraprake nxori "Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës" ("Vendimi i Konfirmimit"),³ "Fletarrestim për z. Salih Mustafa"⁴ dhe "Urdhër për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara"⁵.

3. Më 19 qershor 2020, Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.⁶

¹ KSC-BC-2020-05, F00001, Kryetarja, Vendim për caktimin e gjykatësit të procedurës paraprake, 14 shkurt 2020, publik.

² KSC-BC-2020-05, F00002, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat në lidhje me të*, 14 shkurt 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

³ KSC-BC-2020-05, F00008, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Vendim për konfirmimin e Aktakuzës kundër Salih Mustafës* ("Vendimi i Konfirmimit"), 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁴ KSC-BC-2020-05, F00009/A01/RED, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Versioni i redaktuar publik i fletarrestimi për z. Salih Mustafa*, 12 qershor 2020, publik.

⁵ KSC-BC-2020-05, F00009/A02/RED, Gjykatësi i procedurës paraprake, *Versioni i redaktuar publik i urdhrit për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 qershor 2020, publik.

⁶ KSC-BC-2020-05, F00011/A02, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 2 e Parashtrimit të Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publike. Versioni i redaktuar edhe më tej i Aktakuzës së Konfirmuar u protokollua më 28 shtator 2020 (KSC-BC-2020-05, F00019/A01, Prokurori i Specializuar, *Shtojca 1 e Parashtrimit të versionit të redaktuar edhe më tej të Aktakuzës së Konfirmuar*, 28 shtator 2020, publike).

4. Më 24 shtator 2020, Salih Mustafa ("z. Mustafa" ose "i akuzuari") u arrestua⁷ dhe u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("DHS") në Hagë, Holandë.⁸

5. Më 28 shtator 2020, Administratorja caktoi me kusht Julius von Bone si mbrojtës të z. Mustafa.⁹

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me nenin 20 të Ligjit, gjuhët zyrtare të DHS-së dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") janë shqipja, serbishtja dhe anglishtja, dhe, në çdo proces, paneli mund të vendosë se cilat gjuhë të punës janë të përshtatshme për atë proces dhe duke respektuar plotësisht të drejtat e të akuzuarit, siç është përcaktuar në nenin 21 të Ligjit.

7. Në përputhje me rregullën 8(3)(a) të Rregullores, duke mbajtur parasysh nenin 20 të Ligjit, në fazën më të hershme të mundshme të procesit, pasi t'i ketë dëgjuar palët dhe, kur është e zbatueshme, mbrojtësin e viktimave, paneli merr vendimin se cila ose cilat gjuhë të punës do të përdoren gjatë procesit.

III. DISKUTIM

8. Duke pasur parasysh arrestimin dhe transferimin e z. Mustafa, dhe në pajtim me të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21 të Ligjit, është e nevojshme që të caktohet gjuha e punës në procesin aktual me qëllim që të mundësohet zhvillimi i drejtë, efikas dhe i shpejtë i tij.

⁷ KSC-BC-2020-05, F00013, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

⁸ KSC-BC-2020-05, F00014, Administratorja, *Njoftimi i pranimit në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me një shtojcë, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, para. 2.

⁹ KSC-BC-2020-05, F00020, Administratorja, *Njoftimi i caktimit të mbrojtësit me kusht*, 28 shtator 2020, publike, me një shtojcë, konfidenciale.

9. Gjykatësi i procedurës paraprake vëren se gjuha e procesit deri më tani ka qenë anglishtja, meqë të gjitha parashtrimet nga ZPS-ja dhe të gjitha vendimet dhe urdhrat e gjykatësit të procedurës paraprake kanë qenë në anglishte. Para se të përcaktohet se a ekzistojnë arsye bindëse që të largohemi nga anglishtja si gjuhë e punës në procesin aktual, është e nevojshme që të marrim mendimet e palëve.

10. Gjithashtu, përcaktimi i gjuhës së punës është i domosdoshëm për të siguruar, në fazën më të hershme të procesit qartësi për palët dhe çdo pjesëmarrës, sipas rastit, për përgatitjen dhe organizimin e parashtrimeve të tyre. Gjithashtu, kjo do të shtojë parashikueshmërinë dhe kapacitetin për planifikim të njëjësive të përkthimit brenda Zyrës Administrative dhe ZPS-së.

11. Gjykatësi i procedurës paraprake thekson se përcaktimi i gjuhës së punës nuk ndikon në gjuhën dhe/ose përkthimin e provave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme për përdorim nga i akuzuari.¹⁰

IV. VENDIM

12. Për arsyet e lartpërmendura, gjykatësi i procedurës paraprake u kërkon palëve që të dorëzojnë parashtrimet e tyre në lidhje me gjuhën e punës për procesin aktual deri të **premtën, 2 tetor 2020**.

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatës i procedurës paraprake

E hënë, 28 shtator 2020

Në Hagë, Holandë.

¹⁰ Nenet 21(4)(a) dhe 39(5) të Ligjit; rregullat 86(8), 87(1), 92(2)(b) dhe 102(1) të Rregullores.